



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

## V E N D I M

Nr. 141, datë 30.10.2020

### PËR

### NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E TREGUT PUBLIK TË RROBAVE TË PËRDORURA DHE NXITJEN E VETËPUNËSIMIT PËR KOMUNITETIT ROM DHE EGJYPTIAN

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, nenit 25, pika 1, nenit 28, pika 4, nenit 54 shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, nenit 64, shkronja “a” dhe nenit 66, shkronja “d” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; nenit 15, pika 3 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligjin nr. 57/2019, datë 18.07.2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar; nenit 3 pika 2 e ligjit nr. 96/2017, datë 13.10.2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”; vendimit me nr. 1071, datë 23.10.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2015-2020”; vendimit nr. 1072, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve, 2016-2020”, vendimit nr. 76, datë 20/07/2001 të Këshillit Bashkiak “Mbi miratimin e rregullores për ndërtimin dhe funksionimin e tregjeve”; vendimit nr. 158 , datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”; vendimit nr. 4, datë 31.01 2018 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e planit të zhvillimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës (2018-2020)”; Vendimit nr. 130, datë 15.11.2018 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe rregullat e zënies së hapësirës publike në Bashkinë e Tiranës” ; Urdhrit nr. 17904 datë 7.05.2018 të kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e procedurave të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik Urban në Bashkinë Tiranë”; Marrëveshjes së Financimit nr. 27619 prot, datë 19.08.2020 e nënshkruar ndërmjet Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë dhe Bashkisë Tiranë, si dhe vendimit të Këshillit Teknik nr. 16 prot., datë. 07.10.2020, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

### V E N D O S I:

1. Ngritjen dhe funksionimin e tregut publik “Rroba të Përdorura” të ndodhur midis rrugës “Hamdi Pepa” dhe “Mustafa Haska”, në pasurinë me nr.3/685, ZK 8240, vol. 8, faqja 222, Indeks Harte TR; S-6, truall me sipërfaqe 1211.3 m<sup>2</sup>, e cila administrohet nga Bashkia Tiranë, shoqëruar me të gjithë dokumentacionin përkatës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Miratimin e marrëveshjes së financimit të nënshkruar midis Bashkisë Tiranë dhe Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, për përcaktimin e mënyrave të bashkëpunimit mes palëve për realizimin efektiv të projektit “Për krijimin e një tregu publik të rrobave të përdorura me qëllim formalizimin e tregtisë ambulatorie dhe nxitjen e vetëpunësimit për komunitetin Rom dhe Egjiptian” në zonën e Selitës, sipas tekstit që i bashkëlidhet dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Subjektet, pjesë e komunitetit Rom dhe Egjiptian, që do tregtojnë në tregun publik të rrobave të përdorura, të përjashtohen nga detyrimi i tarifës për zënien e hapësirës publike për një periudhë 1 (një) vjeçare nga hapja e tregut.
  4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit të ndjekë procedurat përkatëse për transferimin përfundimtar në pronësi të Bashkisë Tiranë të pasurisë së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
  5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Agjencia e Administrimit të Tregjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**K R Y E T A R**

**TONI GOGU**